



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1136/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Milena Đjeric dhe Adnan Konushevi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Viti, Thyerjes se Heshtjes Zgjedhore në afërsi të Qendrës së Votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.11.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.1136/2021 e datës 14.11.2021 , e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që Subjektit Politik Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan t'i shqiptohet gjobë për shkak të Thyerjes se Heshtjes Zgjedhore në afërsi të Qendrës së Votimit, për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të datës 14.11.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 14.11.2021, ka pranuar ankesën Anr.1120/2021, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, me të cilën pretendon se aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se deputeti i LVV-së Shemsi Syla është parë pranë vendvotimit në shkollën Thimi Mitko në Gjilan duke biseduar me të rinj dhe duke ndikuar tek ata e duke iu bërë thirrje për votim. Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së.

Më tej parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i, që subjekti politik LVV, të sanksionohet sipas legjislacionit në fuqi.

Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur tri fotografi të printuar.

Në përgjigje në ankesë të datës 14.11.2021, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), konsideron se pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës janë jo të drejta dhe të pabazuara, për faktin se nga fotografit e ofruara si dëshmi nuk mund të dëshmohet se personi i fotografuar është Shemsi Syla, andaj edhe propozon që ankesa të refuzohet e pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se ne afërsi te shkollës Thimi Mitko në Gjilan aktivistet e subjektit politik LDK kane kanë vërejtur se deputeti i LVV-së Shemsi Syla është pranë pranë vendvotimit në shkollën Thimi Mitko në Gjilan duke biseduar me të rinj dhe duke ndikuar tek ata e duke iu bërë thirrje për votim.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk mund të identifikohet se personi në fjalë në fjalë është Shemsi Syla ashtu siç pretendohet në ankesë sepse nga fotoja e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se i njëjti është duke qëndruar pranë shkollës e cila shërben si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë, duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1136/2021 më datën 15.11.2021

Kryesuesi i Panelit

Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.